




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Pranuar - Primitjen Më/Dana 08.04.2022			
Nr. i organit Org. broj	Numer/Broj	Shtojtë Prilog	Vlera Vrednos
01/MA/05 -		395	

Në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 40, paragrafi 2, shkronja e dhe neni 51 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Udhëzimin Administrativ MAPL-05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, neni 36 shkronja d, neni 40, 47 shkronja e të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.03.2022, merr këtë:

V E N D I M

për formimin e Komitetit për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Komitetit për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtjen të Mjedisit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 2

Komiteti për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit ka 5 (pesë) anëtarë, dhe atë:

1. Ekrem Ymeri, anëtar i Kuvendit përfaqësues nga subjekti politik LDK
2. Durim Sylejmani, anëtar i Kuvendit përfaqësues nga subjekti politik LVV
3. Remzi Salihu, anëtar i Kuvendit përfaqësues nga subjekti politik LVV
4. Anisë Zejnullahu, anëtare e Kuvendit përfaqësuese nga subjekti politik PDK
5. Arlinda Sahiti, anëtare nga jashtë Kuvendit

Komitetit për planifikim, rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit, në mbledhjen e parë do ta zgjedh kryesuesin e këtij komiteti.

Neni 3

Komiteti nga neni 1 i këtij vendimi, ka për detyrë që të shqyrtoj çështje e planifikimit, rregullimit të hapësirës dhe mbrojtje të mjedisit dhe të jep vërejtje, propozime dhe sugjerime lidhur me planifikimin, rregullimin e hapësirës dhe mbrojtjen e mjedisit për Komune e Vitisë.

Neni 4

Anëtarët Komitetit për planifikim, rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit, të emëruar në neni 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen kryesuesi i Kuvendit dhe kryesuesi i Komitetit.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të Komitetit; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi